



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 22 janar 2013  
Nr.Ref.:RK352/13

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

Në

**Rastin nr. KI 35/12**

Parashtuesi

**Agron Prenaj**

**Kërkesa për vlerësimin e Kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës  
Supreme PKL. 11/2012, të 6 shkurtit 2012.**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan Gjyqtar  
Altay Suroy, Gjyqtar  
Almiro Rodrigues, Gjyqtar  
Snezhana Botusharova, Gjyqtare  
Kadri Kryeziu, Gjyqtar  
Arta Rama – Hajrizi, Gjyqtare

### **Parashtruesi i Kërkesës**

- 1 Parashtruesi i kërkesës është z. Agron Prenaj, me vendbanim në fshatin Novesellë- Komuna e Gjakovës, i përfaqësuar nga avokati Mustafë Kastrati nga Peja.

### **Vendimi i kontestuar**

- 2 Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës PKL. 11/2012, të nxjerrë më 6 shkurt 2012.

### **Objekti i çështjes**

- 3 Parashtruesi i kërkesës është dënuar për keqpërdorimin e së drejtës së votimit në pajtim me nenin 178 (1) i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK).

### **Baza juridike**

- 4 Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

### **Procedura në Gjykatën Kushtuese**

- 5 Më 2 prill 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Gjykata").
- 6 Me vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. 35/12 të 11 prillit 2012) Robert Carolan u caktua si Gjyqtar raportues.
- 7 Në të njëjtën ditë, me vendimin Nr. KSH. 35/12, Kryetari i Gjykatës caktoj Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (Gjyqtar kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.
- 8 Më 7 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese përmes një shkrese e informoi avokatin e parashtruesit të kërkesës se kërkesa e tij ishte regjistruar.
- 9 Më 8 qershor 2012, Gjykata Kushtetuese, përmes një shkrese e informoi Gjykatën Supreme se parashtruesi i kërkesës kishte aplikuar për shqyrtim të vendimit Pkl. 11/2012, të 6 shkurtit 2011 dhe ia bashkëngjiti një kopje të kërkesës.
- 10 Më 2 korrik 2012, Kryetari me vendimin GJR. 35/12 e ri-caktoi Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (Gjyqtar kryesues), Mr.Sc. Kadri Kryeziu, është caktuar për ta zëvendësuar Gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj, pasi që mandati i saj si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese kishte skaduar më 26 qershor 2012, dhe Ivan Čukalović, është caktuar për ta zëvendësuar Gjyqtaren Iliriana Islami sepse mandati i saj si gjyqtare në Gjykatë kishte skaduar më 26 qershor 2012.

- 11 Më 17 janar 2013, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

- 12 Më 12.12.2010, parashtruesi i kërkesës ishte ngarkuar me detyrën e furnizimit me ushqim dhe ishte regjistruar si Vëzhgues për subjektin politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Qendrën e Votimit nr. 0210 C, në vendvotimin 04 D, në shkollën fillore "Shtjefën Kurti" në fshatin "Novesellë e Epërme", Komuna e Gjakovës.
- 13 Rreth orës 13:00 ai ndihmoi nënën e tij për të votuar dhe rreth orës 15:00 edhe ai votoi .
- 14 Pas kësaj, ai shkoi për të ngrënë drekë, në qytetin fqinj dhe ishte kthyer ndërmjet orës 17:30 dhe 18:00.
- 15 Pas kësaj, ai hyri në dhomën e votimit dhe ishte raportuar të ketë tentuar të votojë për herë të dytë. Ai u tha vëzhguesve dhe komisionarëve "Unë do të votoj dhe ju nuk mund ta më ndaloni ", por u ndalua nga ata. Parashtruesi deklaroi se kjo ishte një shaka, të cilën gjë Gjykata Komunale e kishte refuzuar.
- 16 Kryesuesi i vendvotimit, MM, ka deklaruar se në përputhje me detyrat e tij, ai e kishte njoftuar atë se ai mund të votojë vetëm një herë, në të cilën gjë parashtruesi tha se ai kishte qenë vetëm në përcjellje.
- 17 Mundësia se parashtruesi kishte një thikë në dorën e tij kur ai eci drejt kutisë së votimit iu paraqiti gjykatës në deklaratën e P.Q., dhe parashtruesi u mbrojt duke thënë se në të vërtetë ata ishin çelësat e veturës.
- 18 Gjykata Komunale në Gjakovë në aktgjykimin e saj P. nr. 7/2011 të 13 prill 2011, e shpalli parashtruesin fajtor për keqpërdorimin e së drejtës së votimit në pajtim me nenin 178(1) të KPPK. Ai u dënua me një gjobë prej 250 eurove.
- 19 Prokurori Publik i Qarkut në Pejë ushtroi ankesë kundër aktgjyqimit mbi bazën se dënimi ka qenë tepër i butë. Gjykata e Qarkut në Pejë (AP. Nr. 52/11 të 31 dhjetorit, 2011) aprovoi ankesën e prokurorit se rreziku social dhe pasojat e veprës penale të kryer nuk korrespondojnë me dënimin.
- 20 Gjykata e Qarkut në Pejë gjeti se Gjykata Komunale i kishte marrë në konsiderim vetëm rrethanat lehtësuese dhe jo ato rënduese, siç është fakti se si një vëzhgues parashtruesi i kërkesës është dashur të ketë më tepër përgjegjësi së paku ta mënjanojë keqpërdorimin e votës,. Përveç gjobës, parashtruesi ishte dënua me tre muaj me burgim.
- 21 Parashtruesi i kërkesës, i përfaqësuar nga mbrojtësi i tij, ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut AP. Nr. 52/11 të 31 dhjetorit 2012.
- 22 Mbrojtësi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve të dispozitave të KPPK (neni 1 (3), neni 7 dhe neni 14), dhe të KPPPK (neni 404 (1.2), neni 157 (1) dhe neni 322 (3)) dhe dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet (neni 51.1 dhe neni 84.2).

- 23 Me parashtrësën e Prokurorit të Shtetit, KMLP. 11. 9/2012 i 24.01.2012, u propozua që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
- 24 Sa i përket neneve 1 (3), 7 dhe 14 të KPPK, në lidhje me nenin 404 (1.2) të KPPPK, mbrojtësi pohoi se Gjykata e Qarkut nuk e dëshmoi elementin subjektiv të paramendimit të veprës siç ata pohojnë se qëllimi i tij ishte të bënte shaka me ata në vendvotim, e jo të kryejë veprë penale, dhe posaçërisht se kjo veprë nuk ishte aq e rëndë sa që t'i takojë veprave penale të parapara me nenin 7.
- 25 Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. No. 11/2012, në shpalljen e pretendimeve si të pabazuara, arsyetoi se mbrojtësi nuk i ka kuptuar këto dispozita ligjore dhe është thirrur në bazë të gabuar ligjore, sepse paragrafi 3 i nenit 1 të KPPK ka të bëjë me parandalimin e analogjisë dhe ky rast ka të bëjë me veprë penale, të përcaktuar në mënyrë të qartë në pajtim me parimin e ligjshmërisë. Neni 14 i KPPK ka të bëjë me lidhjen shkakore ndërmjet veprimit dhe pasojave. Në këtë rast nuk kishte asnjë dyshim sa i përket kësaj lidhjeje (neni 178 i KPPK dikton se veprimi konsiderohet si i kryer në përpjekjen e thjeshtë për të votuar).
- 26 Mbrojtësi pohoi se Gjykata i ka shkelur nenet 157(1) dhe 322 (3) të KPPPK pasi që ata e dënuan të akuzuarin duke u bazuar vetëm në dëshminë e P.Q., një vëzhgues i OJQ-së BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese) dhe nuk i detyruan dy dëshmitarët tjerë, të cilët e injoruan ftesën e Gjykatës për të dëshmuar. Por, parashtruesi nuk ka treguar cila provë kritike nuk është pranuar nga gjykata e rregullt, ashtu që është shkelur e drejta e tij kushtetuese për gjykim të drejtë.
- 27 Ata gjithashtu pretendojnë se është shkelur neni 51.1 i Ligjit për Zgjedhjet, sepse ankesa është dashur t'i adresohet Komisionit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) dhe Gjykata nuk e siguroi këtë provë. Gjithashtu, është pretenduar një shkelje e ngjashme e nenit 84.2 pasi që Lista Zgjedhore nuk u paraqit si provë dhe nuk u kërkua ndihma e menjëhershme e policisë.
- 28 Gjykata Supreme konsideron se KPPK (neni 451) në mënyrë eksplicite përcakton bazën ligjore për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe shkelja e Ligjit për Zgjedhjet nuk është njëra nga këto baza ligjore.
- 29 Gjykata Supreme theksoi se ajo nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se përpjekjet mbrojtësit që të ri-adresojë -për shembull- disponueshmërinë e dëshmitarit dhe peshën e vënë në deklaratat e tyre nuk do të (ri) shqyrtohet nga ana e Gjykatës.
- 30 Gjykata Supreme shqyrtoi dosjen e lëndës në pajtim me nenin 454 (1) në lidhje me nenin 355 (1) të KPPPK dhe e shpalli kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar.

### **Pretendimet e Parashtruesit**

- 31 Parashtruesi thekson se me vetë faktin që i akuzuari është dënuar në bazë të një shakaje të pretenduar është shkelur dinjiteti i tij në pajtim me nenin 23 të Kushtetutës në lidhje me nenin 31 (4) të së njëjtës.
- 32 Për më tepër, Parashtruesi pretendon se faktet dhe situatat e caktuara nuk janë sqaruar nga gjykatat, siç janë: se a kanë qenë në të vërtetë çelësat apo thika në dorën, se a ka votuar ai në të vërtetë me nënën e tij herën e parë dhe në çfarë

cilësie ka qenë ai kur ka marrë pjesë, a ka qenë furnizues i ushqimit apo vëzhgues. Pra, ai pretendon se dënimi është marrë mbi supozimet të thjeshta, e jo në dëshmi.

- 33 Me paraqitjen e kërkesës në këtë Gjykatë, parashtruesi dëshiron të realizojë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
- 34 Parashtruesi pretendon se ai ishte dënuar vetëm në bazë të dëshmisë të dëshmitarit të incidentit, P.Q., një vëzhgues i OJQ BIRN.

### **Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës**

- 35 Edhe pse Parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore për të realizuar të drejtën e të pretenduar për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç parashihet në nenin 113.7 të Kushtetutës, ai nuk ka paraqitur ndonjë provë apo fakt relevant me të cilin do të mbështesë konkluzionin e tij se “autoritetet administrative apo gjyqësore kanë bërë shkelje të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë” (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i pranueshmërisë së GJEDNJ në rastin nr. 53363 të 31 majit 2005).
- 36 Gjykata Kushtetuese përsërit se nuk është detyrë e saj që të veprojë si një gjykatë apeli, apo gjykatë e shkallës së katërt, në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat e caktuara të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
- 37 Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
- 38 Prandaj, duke i shqyrtuar dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës Gjykata Kushtetuese nuk gjen se procedurat relevante ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i pranueshmërisë së GJEDNJ në rastin nr. 53363 të 31 majit 2005).<sup>3</sup>


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 46 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri:

## VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**

  
Robert Carolan

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

  
Prof. Dr. Enver Hasani

